



GREENBRIDGE - Programi i Lëndës

Kursi mbi Aftësitë e Gjelbra - 1.2 Elementet Kyçe të Ekonomisë së Gjelbër

Përshkrimi i përgjithshëm i kursit

Ky kurs u ofron mësimdhënësve të arsimit profesional (VET) një kuptim më të thelluar mbi ekonominë e gjelbër dhe rëndësinë e saj për arsimin, industrinë dhe tregun e punës. Ekonomia e gjelbër ndërthur zhvillimin ekonomik me qëndrueshmërinë mjedisore, duke promovuar efikasitetin e burimeve, inovacionin dhe qëndrueshmërinë ndaj sfidave.

Një pjesë e rëndësishme e kursit është edhe ekonomia qarkore, dokumentacioni dhe legjislacioni që lidhet me të, si dhe efikasiteti i burimeve - duke theksuar se burimet janë element thelbësor i çdo biznesi dhe përdorimi i tyre i qëndrueshëm është i domosdoshëm.

Analiza e Nevojave ka treguar një mungesë të dukshme në lidhjen e koncepteve të ekonomisë së gjelbër me arsimin profesional dhe praktikat profesionale në Ballkanin Perëndimor. Ky kurs synon ta adresojë këtë boshllëk duke:

- Qartësuar përkufizimet dhe dimensionet e ekonomisë së gjelbër.
- Shpjeguar se si politikat e gjelbra ndikojnë industrinë dhe tendencat e tregut të punës.
- Prezantuar parimet e ekonomisë qarkore dhe efikasitetit të burimeve.

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të kursit, mësimdhënësit e VET do të jenë në gjendje të:

1. Marrin njohuritë e nevojshme mbi përkufizimet dhe dimensionet e ekonomisë së gjelbër dhe rëndësinë e tyre për arsimin profesional.
2. Kuptojnë dhe mësojnë parimet e ekonomisë qarkore dhe efikasitetit të burimeve në kontekstin e formimit profesional.
3. Ndhmjnë nxënësit të lidhin konceptet e ekonomisë së gjelbër me profesionet e tyre të ardhshme, duke rritur ndërgjegjësimin dhe besimin në aftësitë e gjelbra.
4. Të identifikojnë përfitimet kryesore të tranzicionit drejt ekonomisë qarkore.



5. Të gjejnë dhe kuptojnë dokumentet ligjore dhe rregullative që lidhen me temat e kursit.

Struktura dhe përmbajtja e kursit

Moduli 1: Hyrje në ekonominë e gjelbër

Ky modul u jep mësimdhënësve një kuptim të qartë dhe gjithëpërfshirës të ekonomisë së gjelbër dhe kornizës së saj shumëdimensionale. Prezanton konceptin e ekonomisë së gjelbër dhe dallimet e saj nga modelet tradicionale ekonomike, duke trajtuar parimet kryesore si rritja me pak karbon, përfshirja sociale dhe qëndrueshmëria mjedisore. Moduli eksploron dimensionet mjedisore (ndryshimet klimatike, biodiversiteti), sociale (barazia, përfshirja), dhe ekonomike (inovacioni, krijimi i vendeve të punës) dhe lidhjet me politikat globale e rajonale si Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane (EU Green Deal).

Nënkapitujt:

- 1.1 Përkufizimi i ekonomisë së gjelbër
- 1.2 Dimensionet ekonomike të ekonomisë së gjelbër
- 1.3 Dimensionet sociale dhe mjedisore të ekonomisë së gjelbër

Moduli 2: Politikat e gjelbra, industritë dhe tregu i punës

Ky modul trajton mënyrën se si politikat e gjelbra ndikojnë kërkesën për aftësi profesionale dhe krijojnë mundësi në tregun e punës. Prezantohen politikat kryesore ndërkombëtare (EU Green Deal, Marrëveshja e Parisit) dhe ato rajonale që udhëheqin tranzicionin e gjelbër.

Përdoren shembuj nga energjia e ripërtëritshme, menaxhimi i mbeturinave dhe sektorë të tjerë për të ilustruar mundësitë dhe sfidat për industri të ndryshme. Gjithashtu trajtohet krijimi i profesioneve të reja si teknikët e energjisë së ripërtëritshme dhe specialistët e eko-inovacionit si dhe transformimi i profesioneve ekzistuese. Në fund, moduli analizon mospërputhjen e aftësive në rajon dhe rolin që mund të luajë arsimi profesional.

Nënkapitujt:

- 2.1 Përmbledhje e politikave të gjelbra
- 2.2 Ndikimi në industri
- 2.3 Transformimi i tregut të punës

Moduli 3: Ekonomia qarkore dhe efikasiteti i burimeve

Ky modul synon të thellojë njohuritë e mësimdhënësve mbi parimet e ekonomisë qarkore dhe efikasitetit të burimeve, si dhe t'i mbështesë ata në integrimin e këtyre koncepteve në mësimdhënien profesionale.



Moduli shpjegon parimet bazë si: reduktimi, ripërdorimi, riciklimi, ridizenjimi dhe riparimi duke i krahasuar me modelin tradicional “*merr-përdor-hidhe*”. Fokus i veçantë i kushtohet sektorëve si energjia e ripërtëritshme dhe menaxhimi i mbeturinave, si dhe profesioneve të reja që lidhen me eko-inovacionin. Në fund, paraqiten shembuj konkretë të zbatimit të ekonomisë qarkore dhe efikasitetit të burimeve.

Nënkapitujt:

- 3.1 Bazat e ekonomisë qarkore dhe njohja me dokumentet kryesore
- 3.2 Efikasiteti i burimeve në praktikë dhe lidhja me ekonominë qarkore
- 3.3 Shembuj të mirë të zbatimit të ekonomisë qarkore dhe efikasitetit të burimeve

Aktivitetet mësimore

- Mësim i pavarur online me materiale të përgatitura (tekst, imazhe, video të gjeneruara me vegla të Intelgjencës Artificiale)
- Sesione me ligjëruesin për prezantimin e materialit të ri
- Diskutime gjatë trajnimit me ligjëruesin

Orari dhe kohëzgjatja e kursit

Moduli	Sesioni me ligjërues (fizik/online)	Mësimi i pavarur
Moduli 1	1 orë	30 min
Moduli 2	1 orë	30 min
Moduli 3	1 orë	30 min
Totali	3 orë	1 orë e 30 min

Metodat e vlerësimit

- Për secilin modul ofrohet një pyetësor vetëvlerësimi me pyetje me nga vetëm një përgjigje.